



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:920726

Datë: 23.02.2021

Numri i dokumentit: 01531422

Ae.nr.23/20

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË-Departamenti për Çështje Ekonomike, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Liridon Maloku, kryetar i kolegjit, Mahir Tutuli dhe Qerim Ademaj, anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditëses M..., me seli në Gjilan, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Shoqëria e Avokatëve "S..., me seli në Prishtinë, kundër të paditurës "I.." me seli në Prishtinë, për shkak të anulimit të pjesshëm të kontratës për shkak të pasurimit të pa bazë, duke vendosur lidhur me ankesën e të paditurës e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.695/18 i datës 03/12/2019, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **10/02/2021**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pa themeltë ankesa e të paditurës I..., me seli në Prishtinë dhe **VËRTETOHET** aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK.C.nr.695/18 i datës 03/12/2019.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktgjykimin e ankimuar IV.EK.C.nr.695/18 i datës 03/12/2019, ka vendosur si në vijim: I. Miratohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses "M..." L.L.C, me seli në Gjilan, e paraqitur kundër të paditurës "I...", me seli në Prishtinë, ashtu që shpallet nule dispozita e nenit 7 e Marrëveshjes mbi Kredinë për biznes, nr..., të datës 03 Korrik 2014, e lidhur në mes paditëses dhe të paditurës, që në emër të kthimit të parakohshëm të kredisë.

II. Detyrohet, e paditura "I..." me seli në Prishtinë, që paditëses "M..." me seli në Gjilan, t'ia kthej shumën e mjeteve financiare prej 89.275.53 euro, të inkasuar në emër të kthimit të përkohshëm të kredis me nr..., të datës 28 Korrik 2014, me kamatë ligjore prej 8%, duke filluar nga data 31.12.2018, të

gjitha brenda afatit prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Detyrohet, e paditura që paditëses t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore, në shumën prej 1099.00 euro, në afatin prej 7 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afatin ligjor ka paraqitur ankesë për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, të vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe të zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që të aprovohet në tërësi ankesa si e bazuar dhe të ndryshohet aktgjykimi ankimor në atë mënyrë që të refuzohet kërkesëpadia e paditëses apo çështja të kthehet në rigjykim dhe rivendosje në gjykatën e shkallës së parë.

Paditësja ka dhënë përgjigje në ankesë, me propozim që të refuzohet ankesa e të paditurës si e pa bazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i Gjykatës së shkallës së parë si i drejtë dhe i bazuar në ligj.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195, dhe 200 të LPK-së, ka gjetur se:

-Ankesa është e pa themeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësja "M..." LLC, me seli në Gjilan, pranë Gjykatës Themelore Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me datën 31/12/2018, ka paraqitur padi kundër të paditurës I...-Dega në Kosovë, me seli në Prishtinë, me kërkesë të precizuar si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditëses, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave të paraqitura nga palët ndërgjyqëse si dhe vlerësimit të të gjitha shkresave tjera të lëndës, ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar, me të cilën e ka aprovuar në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditëses, duke arsyetuar se ndërgjyqësit kanë qenë në raporte kontraktuale sipas Kontratës mbi kredinë nr...., të datës 29/04/2014, nr...., të datës 11/06/2014 dhe sipas Marrëveshjes mbi kredinë me nr...., të datës 03/07/2014 dhe në bazë të këtyre kontratave e paditura i ka lëshuar paditëses kredinë në shumë të përgjithshme prej 2,500,000.00 euro, me normë të interesit vjetor prej 8 % në vit dhe normë efektive të interesit 8.77 %, me afat kthimi prej 58 muaj ndërsa paditësja para kohës ia ka kthyer të paditurës parapagimin e kredisë dhe me qellim të përmbylljes së kredisë është detyruar

paditësja që t'ia paguaj të paditurës edhe shumë prej 89,585.53 euro dhe atë duke u bazuar në nenin 7 të kontratës së cekur më lartë dhe kjo gjendje financiare është vërtetuar me ekspertizë financiare të punuar nga Flamur Keqa. Mbi bazën e kësaj gjendje të vërtetuar faktike, gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave, vendosi si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar, duke u bazuar në dispozitën e nenit 17, 253.3,1068 paragrafi 2, 3 dhe 4 të LMD-së si dhe në dispozitën e nenit 143 paragrafi 1 dhe nenin 452 par.1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së përfundimi dhe qëndrimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika (b), (g), (j), (k) dhe (m) e LPK-së dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të dispozitës së nenit 194 të LPK-së.

Sipas vlerësimit të Gjykatës se Apelit i pathemeltë qëndron pretendimi ankimor i palës ankuese për shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika n) të LPK, ngase aktgjykimi i ankimuar del se nuk është i përfshirë në të meta për shkak të cilave nuk mund të ekzaminohet sepse dispozitivi i aktgjykimit është i qartë e në harmoni të plotë me arsyetimin e aktgjykimit. Në arsyetim të aktgjykimit po ashtu janë dhënë arsye të mjaftueshme dhe bindëse për të gjitha faktet vendimtare të cilat janë marrë në vlerësim nga gjykata e shkallës së parë, e sipas të cilave edhe është vendosë lidhur me themelësinë e kërkesëpadisë. Në këtë kontekst në arsyetim të aktgjykimit janë dhënë arsyeje të duhura për mënyrën e vërtetimit të fakteve për provat e administruara dhe për vlerësimin e tyre sa i përket besueshmërisë dhe fuqisë provuese të tyre. Mandej, nuk qëndron as pretendimi i të paditurës se padia është ngritur pas afatit të paraparë me nenin 102 të LMD-së, për arsye se me nenin 96 të LMD-së është përcaktuar: E drejta e paraqitjes së kërkesës të nulitetit nuk shuhet, ndërsa pretendimet ankimore të paditurës përkitazi me afatshmerin e padis, ju referohet rasteve kur kemi të bëjmë me Kontratë të Rrëzueshme, e që në rastin konkret kemi të bëjmë me një dispozitë kontraktuale e cila është në kundërshtim me ligjin material dhe si e tillë është nule, e gjithashtu gjykata e shkallës së parë ka vendosur brenda kufijve të kërkesëpadisë, andaj të gjitha pretendimet ankimore të paditurës, për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore vlerësohen si të pazbatueshme.

Gjykata e Apelit nuk i ka pranuar pretendimet e ankuesit për gjendjen faktike të konstatuar në mënyrë të gabuar dhe jo të plotë nga ana e gjykatës së shkallës së parë sepse me provat materiale të administruara saktësisht me

dispozitën kontraktuese të nenin 7.2 të Marrëveshjes mbi Kredinë, ndërgjyqësit kanë paraparë: *Nëse kredi marrësi dëshiron të paguaj komplet shumën e kredisë, i njëjti do të paguaj komisionin për këtë pagim të mëhershëm/mbylljen e kredisë x ditët e mbetura deri në fund të maturitetit të kredisë/360 x 2 % tek kredi dhënësi menjëherë në para të gatshme dhe në shumë totale sipas kërkesës së kredi dhënësit, ndërsa me ekspertizën e ekspertit financiar të punuar nga Flamur Keqa është vërtetuar bindshëm se e paditura ka arkëtuar nga paditësja në emër të komisionit para pagues shumën prej 89,285.53 euro, ndërsa e paditura me asnjë provë materiale nuk e argumentoj të kundërtën e asaj që e ka konstatuar eksperti financiar si dhe atë që e ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë mbi bazën e provave të administruara. Në këtë situatë juridike ligjvënësi ka paraparë në nenin 319.1 të LPK-së, si vijon: *Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyrë të provoje faktet mbi të cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta, ndërsa neni 322.3 i po këtij ligji, gjithashtu ka paraparë: Pala e cila e konteston ekzistimin e ndonjë të drejte e bartë barrën e të provuarit të faktit që e ka penguar krijimin apo realizimin e saj, ose në bazë të të cilit ka pushuar se ekzistuari, po që se ligji nuk parasheh diç tjetër.**

Kolegji i Gjykatës së Apelit i shqyrtoj edhe pretendimet tjera të paditurës, përkritazi me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale nga ana e gjykatës së shkallës së parë, por të njëjtat i vlerësoj si të pa bazuara, për arsye se pjesëmarrësit në raportet kontraktuale është fakt se me vullnetin e tyre i rregullojnë marrëdhëniet e tyre detyrimore, por këto marrëdhënie nuk mund ti rregullojnë në kundërshtim me parimet e përcaktuara me normat juridiko-detyrimore, prandaj dispozita e nenit 7 të Marrëveshjes mbi Kredinë është në kundërshtim me nenit 1068 par.4 të LMD-së, që shprehimisht parasheh: *në rastin e kthimit të kredisë para afatit të caktuar, banka nuk mund ta kalkulojë kamatën për kohën prej ditës së kthimit të kredisë deri në ditën kur sipas kontratës është dashur të kthehet*” dhe kjo dispozite kontraktuale nuk prodhon efekt juridik dhe rrjedhimisht e paditura nuk ka mundur të aplikoj në rastin konkret, andaj konform nenit 89 të LMD-së, dispozita e nenit 7 është nule. Sipas nenit 91 të LMD-së, nuliteti i një dispozite kontraktuese, nuk mund të ketë pasojë edhe në nulitetin e vet kontratës, në qoftë se ajo mund të qëndroj pa dispozitën nule, andaj konform kësaj dispozite kjo gjykatë vlerësoj se kontrata ndërmjet palëve kontraktuese pa këtë dispozitë ka mbetur në fuqi. Me dispozitën e nenit 194 par.1 të LMD-së, ligjvënësi ka paraparë që secili person që pasurohet pa bazë ligjore në dëm të një tjetrit, është i detyruar të kthejë atë që ka marrë nga tjetri, ose ndryshe të kompensojë vlerën e fitimit të arritur. Andaj në kuptim të këtyre dispozitave rezulton se gjykata e shkallës së parë me të drejtë e ka gjetur si të themeltë bazueshmërinë e kërkesëpadisë. Janë vlerësuar edhe pretendimet tjera ankimore, por Gjykata e Apelit nuk ka gjetur se aktgjykimi i atakuar është i përfshirë në ndonjë shkelje, që do të

ndikonte në ligjshmërinë e aktgjykimit, prandaj të gjitha pretendimet janë vlerësuar si të pabazuara.

Nga sa u tha më lart u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e në bazë të nenit 195 paragrafi 1 pika (d) dhe 200të LPK-së.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
-Departamenti për Çështje Ekonomike-
Ae.nr.23/20, me datën 10/02/2021

Kryetari i kolegjit-Gjyqtari
Liridon Maloku